



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

014 nr. \_\_\_\_\_, më 16.08.2017

112/02-0203810/17

Në pajtim me dispozitat e nenit 13, nenit 58, pika f dhe nenit 62, paragrafi 62.2 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 52, pika f, nenit 53 dhe nenit 57, paragrafi 57.1 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më 25.07.2016, merr këtë

### V E N D I M

#### PËR CAKTIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË URBANIZMIT

- I. **Ardian Olluri** emërohet në pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, nga data 17.08.2017.
- II. I emëruari do të udhëheqë dhe menaxhojë Drejtorinë në përputhje me udhëzimet e Kryetarit të Komunës, ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.
- III. I emëruari do t’i raportojë rregullisht Kryetarit të Komunës për procesin e vendimmarrjes dhe funksionimin e Drejtorisë që udhëheq.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

U dorëzohet:

- Të emëruarit,
- Njesisë së personelit,
- Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kryetari i Komunës  
Slipeid Ahmeti

